



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PRESIDENTI

Nr. 3423/1 Prot.

Tiranë, më 04.01.2021

Lënda: Mbi përmbushjen e detyrimeve kushtetuese dhe ligjore për lidhjen e marrëveshjes së Huasë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Fondit Saudit për Zhvillim, për Projektin e “*Rehabilitimit dhe ndërtimit të objekteve në afërsi të rrugës bregdetare (Vlorë-Orikum)*” .

MINISTRISË SË FINANCAVE DHE EKONOMISË

Tiranë

Për dijeni:

MINISTRISË PËR EVROPËN DHE PUNËT E JASHTME

Tiranë

Ministria e Financave dhe Ekonomisë me shkresë nr. 16905/6 prot., datë 28.09.2020 drejtuar Presidentit të Republikës ka paraqitur kërkesën për lëshimin e autorizimit për plotfuqi për **nënshkrimin e marrëveshjes** së Huasë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Fondit Saudit për Zhvillim, për Projektin e “*Rehabilitimit dhe ndërtimit të objekteve në afërsi të rrugës bregdetare (Vlorë-Orikum)*” .

Duke qënë se për këtë marrëveshje, me këtë objekt dhe këtë përmbajtje, palë, dhe vlerë, nuk rezultonte që Presidenti i Republikës të kishte lëshuar më parë autorizimin për plotfuqi për negociimin e saj, me shkresën me nr. 3306/1 prot., datë 06.10.2020, u kërkua informacion paraprak lidhur me të gjitha hapat që ishin ndjekur për finalizimin e marrëveshjes, duke filluar nga procesi i negociimit e deri tek faza e kërkesës për nënshkrimin e marrëveshjes së sipërcituar, pas miratimit në parim nga Këshilli i Ministrave.

Me shkresën tuaj me nr. 16905/8 prot., datë 15.10.2020 keni kthyer përgjigje, duke informuar Presidentin e Republikës se, draft marrëveshja e huasë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Fondit Saudit për Zhvillim, për Projektin e Rehabilitimit dhe ndërtimit të objekteve në afërsi të rrugës bregdetare (Vlorë-Orikum), është vënë në dispozicion nga Fondi Saudit për Zhvillim dhe **nuk ka patur negociata, pasi asnjë prej institucioneve që në varësi të fushës së kompetencave janë palë të saj, nuk kanë patur komente apo sugjerime mbi këtë draft marrëveshje, e për rrjedhojë nuk ka qënë e nevojshme autorizimi për negociim.**

Institucioni i Presidentit të Republikës me shkresën me nr. 3306/3 prot., datë 27.10.2020, ju ka kërkuar informacion shtesë për këtë çështje, për faktin se, **përsërisim: kjo hua është e dedikuar, sipas relacionit shoqërues, për projektin e ndërhyrjes në zonën nga Tuneli te Marina, Oriku.** Ndaj, patjetër që për evidentimin e nevojës për huamarrje me qëllim realizimin e këtij projekti, duhet të jenë investuar institucionet vendase përgjegjëse për realizimin e tij. Nëse nuk ka patur një investim nga këto institucione, **por Fondi Saudit për Zhvillim ka paraqitur propozimin e tij, duke e cilësuar “të panegociueshëm”, lutemi të na vini në dispozicion dokumentacionin që evidenton këtë fakt.**

Ndaj u kërkuua vënia në dispozicion e kopjes së korrespondencës jo vetëm **me Fondin Saudit për Zhvillim**, por edhe të **korrespondencës ndërinstitucionale** që ishte mbajtur për këtë draftmarrëveshje.

Me shkresën me **nr. prot. 16905/10, datë 2.11.2020**, ministrja e Financave dhe Ekonomisë iu përgjigj kërkesës së Presidentit, por duke iu shmangur dhënies së shpjegimeve për thelbin e kërkesës për informacion- nëse Ministria e Financave dhe Ekonomisë ishte pajisur, me Autorizim nga Presidenti i Republikës për të hyrë në negociata për marrjen e huasë për këtë projekt, apo jo.

Në këtë përgjigje, ministrja e Financave dhe Ekonomisë justifikon edhe një herë veten për faktin se për këtë marrëveshje nuk është marrë autorizim për plotfuqi për negociimin e një drafti me këtë përmbajtje. Pikërisht përmes këtij pohimi, konstatohet se janë shkelur në mënyrë flagrante kërkesat e Kushtetutës dhe të ligjit, të cilat diktojnë detyrimisht që për çdo marrëveshje, duhet më parë që autoriteti publik që drejton këto negociata të autorizohet nga Presidenti i Republikës, për t'u pajisur me plotfuqi për procesin e negociatit.

Ndërkohë që Ministria e Financave dhe Ekonomisë, për mospërmbushjen e këtij detyrimi jep këtë argument, që rezulton i pambështetur në ndonjë ligj. Ministria e Financave citon në shkresën e saj se:

“[...] termat financiare (interesi, kosto të ndryshme administrimit, maturimi, etj.) të financimeve të huaja të akorduara nga ana e institucioneve financiare ndërkombëtare apo shteteve me të cilat vendi ynë bashkëpunon, janë të paracaktuara nga secili prej kundërpalëve në varësi të stadi të zhvillimit ekonomik të vendit dhe ndryshohen në mënyrë periodike prej tyre në varësi të përditësimeve që vlerësohen si faktor i konsiderueshëm në zhvillimin e vendit”.

Ndërmjet kësaj korrespondence, Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka bashkëlidhur dhe përgjigjen e Fondit Saudit për Zhvillim, të datës 24.8.2020, përmes së cilës shprehet dakordësia për të kryer transferimin e fondeve nga projekti “Rehabilitimi i Rrugës së Lumit të Vlorës, Loti IV”, në projektin e ri “Rehabilitimit dhe ndërtimit të objekteve në afërsi të rrugës bregdetare (Vlorë-Oriku)”.

Nga shqyrtimi i kësaj letre të Fondit Saudit për Zhvillim rezulton se, kërkesa për të anuluar financimin e mëtejshëm të investimit të ndërtimit të aksit **Peshkëpi-Selenicë** nën projektin “Rehabilitimi i Rrugës së Lumit të Vlorës, Loti IV”, dhe kërkesa për financimin e segmentit “Rehabilitimit dhe ndërtimit të objekteve në afërsi të rrugës bregdetare (Vlorë-Orikum)”, nuk kanë ardhur si propozime të Fondit Saudit, por kanë qënë kërkesë e institucioneve shqiptare.

Ka qënë pikërisht qeveria shqiptare që në muajin Shkurt 2020, i ka kërkuar Fondit Saudit për Zhvillim anulimin e financimit të projekti të “Rehabilitimi i Rrugës së Lumit të Vlorës, Loti IV”, duke i dhënë fund marrëveshjes së huasë të lidhur dhe ratifikuar me ligjin nr. 100/2017. Për mbylljen e kësaj marrëveshjeje, qeveria i ka propozuar Kuvendit dhe është miratuar ligji nr. 117/2020 “Për denoncimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Fondit Saudit për Zhvillim për financimin e projektit “Rehabilitimi i rrugës së Lumit të Vlorës”, ratifikuar me ligjin nr. 100/2017”.

Ndërkohë që, për të realizuar financimin e këtij projekti të ri, të shpallur si “shumë prioritar”, qeveria përmes Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, ka shmangur gjithë procedurat e brendshme ligjore duke e bërë fakt të kryer financimin e këtij projekti, **pa negociuar më parë kushtet e financimit të tij.**

Për më tepër, nga shqyrtimi i praktikës, rezulton se përkundër qëndrimit dhe pretendimit të sipërcituar të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Fondit Saudit për Zhvillim nuk ka asnjë pretendim **për terma financiare të parapërcaktuara, që të vinte palën shqiptare në pozitën e pamundësisë për të negociuar.**

Për sa më sipër:

- Presidenti i Republikës, për të mundësuar autorizimin për plotfuqi për nënshkrimin e kësaj marrëveshjeje, kërkoi dokumentacionin dhe informacion të qartë nëse, për këtë marrëveshje ishte kryer procesi i negociimit sipas kërkesave të ligjit nr. 43/2016 “Për marrëveshjet ndërkombëtare”.
- Ministrja e Financave dhe Ekonomisë, qartazi pranoi shkeljen (fatkeqësisht të përsëritur) të ligjit nr. 43/2016 “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, **duke pranuar se nuk kishte zhvilluar proces negociimi.**
- Vetë Këshilli i Ministrave, me vendimin nr. 745, datë 23.09.2020, ka miratuar në parim këtë marrëveshje huaje, në shkelje flagrante të procedurës që kërkon Kushtetuta dhe ligji, **duke miratuar një dokument që nuk ishte negociuar.**

- Rregullat dhe procedurat e lidhjes së marrëveshjeve ndërkombëtare, përfshirë ato të huamarrjes, janë të përcaktuara qartë në Kushtetutë, ligjin nr. 43/2016 “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”.
- Sipas këtij ligji, **plotfuqia** është dokumenti që lëshohet nga autoriteti kompetent i Republikës së Shqipërisë, që autorizon një ose disa zyrtarë të **përfaqësojnë shtetin apo Qeverinë në zhvillimin e negociatave, parafimin dhe nënshkrimin e një marrëveshjeje ndërkombëtare.**
- Fazat që i paraprijnë ratifikimit/pranimimit/aderimit/miratimit të një marrëveshjeje, janë ato **të zhvillimit të negociatave;** parafimit si akti me të cilin personat e autorizuar vënë inicialet (siglojnë) për të treguar se kanë rënë dakord për tekstin përfundimtar të marrëveshjes; miratimit në parim; dhe më pas nënshkrimit përfundimtar.
- Ligji nr. 43/2016, në nenin 10, që vetë Këshilli i Ministrave ka përdorur si bazë ligjore në Vendimin për miratimin në parim të draftmarrëveshjes, përcakton se:
 - “1. **Pas përfundimit të procesit të negocimit,** projekt marrëveshja ndërkombëtare miratohet, në parim, nga Këshilli i Ministrave, me propozimin ose bashkëpropozimin e ministrisë/ve kompetente.
 - 2. Propozimi për miratimin, në parim, të marrëveshjes përmban:
 - a) projektvendimin për miratimin në parim;
 - b) **tekstin e marrëveshjes në gjuhën e negociuar;**
 - c) *tekstin e marrëveshjes, të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të certifikuar nga Ministria e Drejtësisë;*
 - ç) *mendimet e ministrive dhe institucioneve të interesuara;*
 - d) *relacionin shpjegues, sipas pikës 4, të nenit 8, të këtij ligji, përfshirë argumentet për pranimin ose jo të propozimeve e të vërejtjeve të ministrive të interesuara. [...]*”
- **Për zhvillimin e negociatave nevojitet pajisja me plotfuqi.** Në rastin konkret, sipas nenit 6, pika 3, shkronja “a)”, duke qënë se marrëveshja negociohet dhe nënshkruhet në emër të Republikës së Shqipërisë dhe duhet ratifikuar me ligj, **plotfuqia për negociim lëshohet nga Ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme, pas autorizimit të dhënë nga Presidenti i Republikës.**
- Marrëveshjet që lidhen në emër të Republikës së Shqipërisë dhe institucioneve të tjera ndërkombëtare i nënshtrohen përcaktimeve ligjore të sanksionuara në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, si dhe në ligjin nr. 43/2016 “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, referenca këto të cilat janë të detyrueshme për cilindo institucion që kërkon të negociojë dhe nënshkruajë një marrëveshje ndërkombëtare në emër të Republikës së Shqipërisë.

- **Kjo marrëveshje, de facto është negociuar**, ndërkohë që për efekt të zbatimit të ligjit konsiderohet e panegociuar, për sa kohë që Ministria e Financave dhe Ekonomisë nuk ka patur në dispozicion plotfuqinë për këtë qëllim në mbajtjen e komunikimeve.

Për këtë marrëveshje, Presidenti i Republikës nuk ka dhënë autorizimin për lëshimin e plotfuqisë për negociim.

Për sa më sipër, rezulton se:

1. Këshilli i Ministrave, ka shkelur kërkesat e ligjit nr. 43/2016, nenin 92/ë të Kushtetutës dhe Vendimin nr. 15/2010 të Gjykatës Kushtetuese që e ka interpretuar atë, sipas të cilit për të arritur në nënshkrimin e një marrëveshje ndërkombëtare, është e detyrueshme që një draft i saj të negociohet, nga një grup negociator i propozuar nga Ministri përgjegjës, dhe i miratuar nga Presidenti i Republikës, me autorizim.

Në rastin konkret, kur **nuk është lëshuar një autorizim nga Presidenti**, Këshilli i Ministrave, duke shmangur këtë kërkesë **ka miratuar në parim draft marrëveshjen e huasë, dokument ky i panegociuar.**

2. Marrëveshja e huasë është një marrëveshje që lidhet nga Republikës së Shqipërisë dhe që duhet të ratifikohet me ligj, për sa kohë përfshihet në parashikimet e nenit 121, paragrafi 1, shkronja “ç)” e Kushtetutës, që sanksionon se:

“1. Ratifikimi dhe denoncimi i marrëveshjeve ndërkombëtare nga Republika e Shqipërisë bëhet me ligj në rastet kur ato kanë të bëjnë me: [...] ç) marrjen përsipër të detyrimeve financiare nga Republika e Shqipërisë; [...]”.

Për sa më sipër, Kushtetuta dhe ligji kërkojnë që miratimi në parim dhe nënshkrimi i një marrëveshje, të bëhet mbi bazën e draf-marrëveshjes së negociuar, dhe jo të një marrëveshjeje të paracaktuar, apo të negociuar në mënyrë të fshehtë.

3. Përveç shkeljeve të mësipërme flagrante të Kushtetutës dhe ligjit (që tashmë janë përsëritur disa herë nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, por dhe nga vetë Kryeministri për disa marrëveshje ndërkombëtare), më duhet të përmend edhe një fakt tjetër që ka marrë vëmendjen e Institucionit të Presidentit të Republikës që lidhet me objektin e kësaj kërkesë.

Pranë Institucionit të Presidentit të Republikës është administruar, me nr. prot. 3423, datë 06.10.2020, peticioni i disa banorëve të Bashkisë Selenicë, të cilët kanë ngritur zërin kundër

anulimit të investimit të ndërtimit të aksit Peshkëpi-Selenicë, i projektuar për t'u ndërlidhur me autostradën Levan-Tepelenë, pjesë e “Lotit IV të Projektit të Rehabilitimit të Rrugës së Lumit të Vlorës”.

Këta banorë, përmes peticionit të nënshkruar, kanë kërkuar vijimin pa ndërprerje të investimit për Rrugën e Lumit të Vlorës, Loti IV.

Ndërsa, Kuvendi i Shqipërisë ka miratuar ligjin nr. 117/2020 “Për denoncimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Fondit Saudit për Zhvillim për financimin e projektit “Rehabilitimi i rrugës së Lumit të Vlorës”, ratifikuar me ligjin nr. 100/2017”.

Në praktikën parlamentare, kjo nismë legislative për anulimin e marrëveshjes së financimit, arsyetohej se:

*“Sqarojmë se nga fondet e akorduara nëpërmjet marrëveshjes së mësipërme të huas **ishte parashikuar që të realizohej financimi i segmentit Peshkëpi – Selenicë – Kryqëzimi – Levan Tepelenë**, me gjatësi prej 16,4 km, i identifikuar nga ana e FSHZH-së si loti IV i “Projektit të rrugës së Lumit të Vlorës”, ku qëllimi i këtij segmenti është, kryesisht, lidhja e dy rrugëve Levan – Tepelenë – Gjirokastër me rrugën Vlorë – Sarandë, si dhe lidhjen e rajonit të Tepelenës me bregdetin jugor. [...] **Duke qënë se si rezultat i projekteve të tjera të konektivitetit në proces zbatimi nga agjencia zbatuese (FSHZH), përmbushej qëllimi fillestar i projektit, u kërkuar që huadhënësi të përcillte letrën e përfundimit të marrëveshjes së huas për shkak të mosbërjes efektive të saj.**”*

Ndërsa në Raportin e Komisionit për Ekonominë dhe Financat, citohet shprehimisht se:

“Ky denoncim nuk e cenon rëndësinë historike të projektit për rehabilitimin e rrugës së Lumit të Vlorës. Punimet e kryera deri tani në këtë zonë kanë dhënë efekte mjaft pozitive ekonomike e sociale. Këto punime do të jenë të plota kur të përfundohet rehabilitimi i segmentit rrugor Peshkëpi - Selenicë, për të bërë pjesë të kësaj rruge të rëndësishme edhe Bashkinë e Selenicës¹.”

Nga peticioni i nënshkruar, është e qartë se banorët e Bashkisë Selenicë nuk janë informuar për ecurinë e projektit, ndërsa nga praktika parlamentare për **ligjin nr. 117/2020**, rezulton se projekti për Lotin IV- ku përfshihet segmenti **rrugor Peshkëpi- Selenicë**, ka qënë një çështje që ka marrë diskutim të veçantë dhe nga përfaqësues të qeverisë dhe të Kuvendit, gjatë shqyrtimit të saj, ku janë shprehur se puna do të vijojë.

¹ Raporti i Komisionit për Ekonominë dhe Financat, në cilësinë e Komisionit përgjegjës për shqyrtimin e Projektligjit “Për denoncimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Fondit Saudit për Zhvillim për financimin e projektit “Rehabilitimi i rrugës së Lumit të Vlorës”, ratifikuar me ligjin nr. 100/2017”, faqe 3.

Nga shqyrtimi i praktikës parlamentare të ligjit nr. 117/2020, “Për denoncimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Fondit Saudit për Zhvillim për financimin e projektit “Rehabilitimi i rrugës së Lumit të Vlorës”, ratifikuar me ligjin nr. 100/2017, rezulton se, financimi i segmentit Peshkëpi – Selenicë – Kryqëzimi – Levan Tepelenë, me gjatësi prej 16.4 km, i identifikuar nga ana e FSHZH-së si loti IV i “Projektit të rrugës së Lumit të Vlorës”, ku qëllimi është lidhja e dy rrugëve Levan – Tepelenë – Gjirokastër me rrugën Vlorë – Sarandë, si dhe lidhjen e rajonit të Tepelenës me bregdetin jugor, është anuluar pa asnjë lloj konsultimi dhe fondet e këtij projekti, tashmë transferohen në një tjetër projekt, pa asnjë dialog me banorët e zonës, të cilëve u fshihen arsyet e kërkesës për anulimin e financimit me kërkesë të vetë qverisë shqiptare.

Ndërkohë që nga ana tjetër procedurat për financimin e projektit tjetër të “Rehabilitimi dhe ndërtimi objekteve në afërsi të rrugës bregdetare (Vlorë-Orikum)”, janë kryer tërësisht në kundërshtim me Kushtetutën dhe ligjin, pikërisht edhe nën efektin e mosbërjes transparente të të gjithë procedurave të ndjekura.

4. Për më tepër, Kryeministri, në një deklaratë publike të datës 4.01.2021, ka cituar ndër të tjera se,

“[...] qysh nga fillimi i nëntorit presim plotfuqinë një autorizim të Presidentit, pasi kemi bërë gjithë negociatën me Fondin Saudit. Është bllokim total, sepse në momentin që nuk jepet plotfuqia ne nuk e materializojmë dot”.

Nga kjo deklaratë konstatohet qartë se jemi përpara një mashtrimi të rëndë që i bëhet qytetarëve shqiptarë, dhe Institucionit të Presidentit të Republikës, sepse:

- nga njëra anë, **ministri i Financave dhe Ekonomisë konfirmon me shkresë se nuk janë zhvilluar negociata për këtë projekt**; ndërkohë që,
- nga ana tjetër, **Kryeministri citon se ka realizuar një proces negocimi.**

Edhe nëse ka patur një proces negocimi për këtë marrëveshje, siç pretendon Kryeministri, ky proces negocimi është kryer në shkelje të rëndë të Kushtetutës, dhe ligjit nr. 43/2016, i cili kërkon në mënyrë të detyrueshme që për nisjen e procesit të negocimit, duhet patjetër **Autorizim nga Presidenti i Republikës.**

Edhe pas kërkesave të përsëritura zyrtare të Kreut të Shtetit, edhe sot nuk ka një kërkesë për negocimin e kushteve të një marrëveshje të re financimi, por vetëm një kërkesë të pajustificuar ligjërisht, për të kaluar direkt në nënshkrimin e një marrëveshje huaje, pa negociuar më parë kushtet në të cilën kjo hua merret nga shteti shqiptar.

Përmes kësaj kërkesë, qeveria dhe Kryeministri kërkojnë që në shkeljet e rënda të ligjit të përfshijnë dhe Presidentin e Republikës, me qëllim që **këtë model antikushtetutshmërie, ta përdorin edhe në praktika të tjera të ngjashme që qeveria ka në proces.**

Presidenti i Republikës thekson dhe një herë se, Kushtetuta, Ligji nr. 43/2016 dhe Vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr. 15/2010, e qartësojnë shumë mirë se: Qëllimi i plotfuqisë është dhënia e autorizimit nga organi kompetent **për të biseduar me palën tjetër** për çështje që caktohen shprehimisht në objektin e plotfuqisë. Përfaqësuesit e shtetit që pajisen me plotfuqi janë të autorizuar të bisedojnë vetëm për atë që është përcaktuar në mandatin e dhënë për përfaqësim. Në çdo rast, negociimi dhe lidhja e marrëveshjes duhet të bëhet brenda kufijve të përcaktuar në plotfuqinë e dhënë nga organi kompetent (Presidenti). Pra, ky autorizim **duhet të jetë i shprehur në çdo rast si deklaram i vullnetit shtetëror për të hyrë në negociata.** Mosmarrja e plotfuqisë nga Presidenti i Republikës për dhënien e plotfuqisë, sipas ligjit nr. 43/2016, për të hyrë në negociata e bën të pavlefshme gjithë procedurën e negociatave të kryer pa një autorizim të Presidentit të Republikës.

Ndërsa projekte të tilla infrastrukturore me rëndësi të veçantë për ekonominë dhe turizmin në zona të caktuara të vendit, në vend që të ndiqen **me transparencë**, si për mënyrën e financimit, ashtu dhe për fazën në të cilat ndodhet implementimi i tyre, **thjesht anulohen pa asnjë lloj konsultimi dhe fondet planifikohen të transferohen në projekte të tjera, pa dialoguar me banorët e zonës, madje pa i patur ende në dispozicion këto fonde, ndërkohë që të gjitha procedurat për realizimin e këtij projekti, përfshirë dhe ato të marrjes së huasë, janë kryer në shkelje të rëndë të Kushtetutës, ligjit nr. 43/2016, dhe ligjit nr. 9665/2006.**

Për të riparuar këtë të metë të rëndë të praktikës së ndjekur, është e detyrueshme ashtu siç e kemi cituar prej kohësh, që Ministria e Financave dhe Ekonomisë, së pari duhet të pajiset me një autorizim për të zhvilluar një proces kushtetues negociimi me fondin Saudit i Zhvillimit, e më pas në përfundim të rezultatit të negociimit dhe pas miratimit nga Këshilli i Ministrave të kërkojë autorizimin e Presidentit të Republikës, për nënshkrimin e marrëveshjes së huasë.

Presidenti i Republikës mbetet në pritje që Këshilli i Ministrave dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë të përmbushin detyrimet kushtetuese dhe ligjore për lidhjen e kësaj marrëveshjeje.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS

ILIR META